



Deklarata e IFLA-s mbi bibliotekat interkulturore

Biblioteka interkulturore si ndërmjetësuese në një shoqëri shumëkulturore në dialog

Sot jetojmë në një shoqëri gjithnjë e më shumë heterogjene. Në mbarë botën fliten më shumë se 6000 gjuhë. Migracioni internacional po rritet nga dita në ditë, dhe si pasojë numri i njerëzve me identitete komplekse është në rritje gjithashtu.

Globalizimi, qarkullimi më i shpeshtë i popullsisë, komunikimi më i shpejtë, lëvizja e madhe dhe e kollajshme, si dhe pasoja të tjera të shekullit të 21-të e kanë shtuar shumëllojshmërinë kulturore në shumë shtete, aty ku ndoshta më parë nuk ekzistonte, ose i kanë zgjeruar strukturat multikulturore ekzistuese.

"Shumëllojshmëria kulturore" apo "multikulturaliteti" i referohen bashkëjetesës harmonike dhe marrëdhënieve ndërmjet kulturave të ndryshme, ku "kultura duhet të shihet si tërësi e cilësive shpirtërore, materiale, intelektuale dhe emocionale, që karakterizon një shoqëri apo një grup shoqëror, që përveç artit dhe letërsisë dallohen edhe nga forma e jetesës, e bashkëjetesës, vlerave, traditave dhe bindjeve"¹. Vlerat kulturore ose multikulturalizmi janë bazë për forcën kolektive në shoqërinë tonë lokale dhe globale.

Shumëllojshmëria kulturore dhe gjuhësore është trashëgimia e përbashkët e njerëzimit dhe duhet të vlerësohet nga të gjithë dhe prej saj duhet të përfitojnë të gjithë. Është një burim shkëmbimi, inovacioni, kreativiteti, dhe bashkëjetese paqësore mes popujve. "Garancia më e mirë për paqen dhe sigurinë internationale është respekti ndaj shumëllojshmërisë së kulturave, tolerancës, dialogut dhe bashkëpunimit në një klimë të besimit dhe botëkuptimit të ndërsjellë"². Prandaj duhet që bibliotekat e të gjitha llojeve, internationale, nacionale dhe lokale ta pasqyrojnë, mbështesin, nxisin, si dhe të punojnë për dialogun midis kulturave dhe për të drejtat e barabarta qytetare.

Meqë bibliotekat përfaqësojnë interesa dhe shoqëri të ndryshme, ato funksionojnë si qendra mësimi, kulture dhe informacioni. Duke tematizuar shumëllojshmërinë kulturore dhe gjuhësore, bibliotekat bëhen lajtmotiv të principeve dhe lirive themelore si dhe të barazisë së shanseve për të gjithë, për të përfituar nga informacioni dhe dija, përtej vlerave dhe identiteteve kulturore.

Principet

Çdonjëri prej nesh në shoqërinë tonë globale ka të drejtën të përfitojë nga bibliotekat dhe informacioni. Duke patur parasysh shumëllojshmërinë kulturore dhe gjuhësore bibliotekat duhet:

- të punojnë për të gjithë anëtarët e shoqërisë, pa diskriminuar origjinën kulturore apo gjuhën e askujt
- informacionet duhet të përfaqësohen në gjuhët dhe shkrimet e duhura
- të ofrojnë një shumëllojshmëri të gjerë materialesh dhe shërbimesh, që u drejtohen të gjitha grupimeve dhe nevojave të tyre
- të punësojnë punonjës dhe punonjëse që përfaqësojnë shumicën e komuniteteve dhe që janë të kualifikuar për të punuar me komunitetet e ndryshme

¹ Deklarata e përgjithshme mbi shumëllojshmërinë kulturore, UNESCO, 2001(<http://www.unesco.de/443.html?&L=0>)

² Ebda

Bibliotekat dhe qendrat e informacionit në një ambjent me shumëllojshmëri të madhe kulturore dhe gjuhësore përmbajnë shërbime për të gjithë përdoruesit e bibliotekës si edhe oferta që u drejtohen veçanërisht grupimeve kulturore dhe gjuhësore që përfitojnë më pak në një shoqëri. Vëmendje të veçantë duhet t'u kushtohet grupimeve në qoshe të shoqërisë, si: minoriteteve, azilkërkuesve dhe refugjatëve, njerëzve me leje qëndrimi të kufizuar, punëtorëve në lëvizje dhe qytetarëve autoktonë.

Detyrat e bibliotekave multikulturore

Në një shoqëri multikulturore duhet t'i kushtohet vëmendje e veçantë informacionit, aftësisë për të lexuar dhe shkruar, shkollimit dhe kulturës. Përveç kësaj bibliotekat duhet:

- të forcojnë ndërgjegjen për vlerat pozitive të shumëllojshmërisë kulturore dhe dialogut kulturor
- të nxisin respektin për shumëllojshmërinë gjuhësore dhe gjuhën nënë
- të lehtësojnë bashkëjetesën harmonike midis gjuhëve të ndryshme, si edhe mësimin e gjuhëve të huaja që në kopësht
- të ruajnë trashëgiminë gjuhësore dhe kulturore si edhe të përkrahin botimin dhe përhapjen e librave në të gjitha gjuhët relevante
- të përkrahin ruajtjen e traditës së folur dhe të trashëgimisë kulturore jomateriale
- të inkurajojnë personat e grupimet e të gjitha kulturave
- të promovojnë alfabetizimin e informacionit në kohën dixhitale dhe zotërimin e teknikave të informacionit dhe komunikationit
- të promovojnë shumëllojshmërinë gjuhësore në internet
- të inkurajojnë përdorimin e internetit nga të gjithë
- të promovojnë shkëmbimin e dijes dhe shembujve pozitivë në lidhje me pluralizmin kulturor

Administrata dhe funksionimi i saj

Bibliotekat multikulturore presin nga të gjitha llojet e bibliotekave gadishmëri për të ofruar të gjitha llojet e shërbimeve. Aktivitetet bazë të bibliotekave dhe qendrave informative për anëtarët e komuniteteve me kulturë dhe gjuhë të ndryshme duhet të shihen si një tërësi dhe jo si të "ndara" apo "shtesë" dhe duhet të jenë në funksion të kërkesave lokale.

Biblioteka duhet të ndjekë një parim dhe një plan strategjik, që përcakton detyrat, qëllimet, prioritetet dhe shërbimet shumëkulturore. Ky plan duhet të bazohet në një analizë midis kërkesave të përfituesve dhe resurseve të duhura.

Aktivitetet e bibliotekës nuk duhet të zhvillohen të izoluara. Duhet të nxitet bashkëpunimi me grupet më të rëndësishme të përdoruesve si dhe ekspertët lokalë, nacionalë dhe internacionalë.

Masat që duhen marrë

Biblioteka multikulturore duhet të:

- përfshijë media dhe oferta multikulturore, si edhe media dixhitale dhe multimediale
- krijojë mjete për ruajtjen e trashëgimisë kulturore duke u kushtuar vëmendje të veçantë transmetimit kulturor gojor, jomaterial dhe amtar

- të ofrojë kurse që përfshijnë shkollimin e përdoruesve, alfabetizimin informatik, resurset e reja, trashëgiminë dhe dialogun interkulturore si pjesë përbërëse të aktiviteteve të tyre
- ta organizojë dhe ofrojë informacionin në mënyrë të tillë që gjuhët kryesore të mos mungojnë
- marketingu dhe materialet për reklamë të prezantohen në të gjitha këto gjuhë, që të tërheqin sa më shumë komunitete të ndryshme në bibliotekë

Punonjësit e punonjëset e bibliotekës

Punonjësit e punonjëset e bibliotekës janë transmetuesit aktivë të mediave ndaj përdoruesve të bibliotekës. Atyre nuk duhet t'u mungojnë shkollimet profesionale dhe kurset e vazhdueshme mbi temat e komunikacionit interkulturore dhe sensibilizimit, anti - diskriminimit, kulturat dhe gjuhët e ndryshme, si edhe kurse për organizimin e aktiviteteve me komunitetet multikulturore.

Stafi i një biblioteke interkulturore duhet t'i pasqyrojë veçantitë kulturore dhe gjuhësore të komunitetit, duke siguruar në këtë mënyrë vazhdimësinë e identitetit kulturor, duke përfaqësuar komunitetin që përfiton nga biblioteka dhe duke nxitur komunikimin e ndërsjellë.

Financimi, legjislacioni dhe rrjetet

Qeveritë dhe sponsorët e tjerë që janë të përfshirë në vendime, duhen inkurajuar që të ndërtojnë dhe të financojnë biblioteka dhe sisteme bibliotekare, të cilat u ofrohen pa pagesë të gjitha komuniteteve kulturore.

Shërbimet multikulturore të bibliotekës janë në thelb globale. Të gjitha bibliotekat që angazhohen në këtë drejtim duhet të marrin pjesë në rrjetet e rëndësishme lokale, nacionale dhe internacionale të ndërtimit të strategjive. Duhet të bëhen kërkime serioze për marrjen e vendimeve dhe sigurimin e financave. Rezultatet e kërkimeve dhe shembujt e rasteve optimale duhet të përhapen sa më shumë, që të shërbejnë si udhërrëfyes për biblioteka të tjera.

Deklarata duhet të bëhet realitet

Bashkësia ndërkombëtare duhet ta njohë rolin e shërbimeve bibliotekare dhe informative në promovimin dhe ruajtjen e e shumëllojshmërisë kulturore dhe gjuhësore.

U bëjmë apel të gjithëve atyre që mbartin vendimet ndërkombëtarisht nëpër fushat e ndryshme dhe nëpër biblioteka, që ta përhapin sa më shumë këtë deklaratë dhe të marrin masa për ta zbatuar atë dhe principet e saj.

Kjo deklaratë është shtesë e deklaratës të IFLA/UNESCO-s për bibliotekat publike, të IFLA/UNESCO-s për bibliotekat shkollore dhe të deklaratës të IFLA-s në internet.

Kjo deklaratë u pranua nga Kryesia e IFLA-s në gusht 2006 dhe u vërtetua në prill 2008 nga Kryesia Internacionale e Programit të UNESCO-s "Informacion për të gjithë", me sugjerimin që të prezantohet për t'u shqyrtuar në Takimin e 35-të të Konferencës të Përgjithshme të UNESCO-s.